

**Përgatitur nga:
Gajur Salihi**

PROFILI I KOMUNËS SË TEARCËS

Komuna e Tearcës ndodhet rrëzë Malit Sharr, respektivisht në pjesën veri-perëndimore të Republikës së Maqedonisë, duke përfshirë një pjesë të madhe të fushës së Pollogut.

Në perëndim, komuna e Tearcës kufizohet me Republikën e Kosovës, në jug me komunën e Tetovës, ndërsa në veri-lindje me komunën e Jegunovcës.

Deri më vitin 1965 në kuadër të komunës së Tearcës ishte e përfshirë edhe komuna e tanishme e Jegunovcës.

Me organizimin territorial të komunave të vitit 1966 komuna e Tearcës iu bashkua komunës së Tetovës, ndërsa me ndryshimin e ligjit në vitin 1996, kjo komunë u mëvetësua.



Në përbërje të komunës së Tearcës bëjnë pjesë këto trembëdhjetë vendbanime: Nepreshten, Leshkë, Sllatinë, Varvarë, Tearcë, Breznë, Përshefcë, Glllogjë, Jelloshnik, Dobrosht, Odër, Përc dhe Nerasht.

Vendbanimet: Varvarë, Breznë, Jelloshnik dhe Përc, janë vendbanime kodrinoro-malore, ndërsa fshati Nerasht shtrihet në pjesën e djathtë të rrugës regjionale R-405, në pjesën fushore.

Selia e komunës ndodhet në fshatin Tearcë. Komuna e Tearcës paraqet qendër administrative, kulturore dhe ekonomike të kësaj pjese të Pollogut të Poshtëm me sipërfaqe të përgjithshme prej 138,12 km² dhe gjithsejt 22.454 banorë, nga nacionalitete të ndryshme, edhe atë: shqiptarë 18.950 banorë (84.39%), maqedonas 2.739 banorë (12.20%), turq 515 banorë (2.29%), romë 54 banorë (0.24%), serb 7 banorë (0.03%) dhe të tjerë 167 banorë (0.74%). Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002 komuna ka 5.095 familje, gjegjësisht 5.480 shtëpi (banesa).

Në kuadër të komunës së Tearcës funksionojnë 5 shkolla fillore qendrore, edhe atë: Sh.f. "Eqrem Çabej"-Sllatinë; Sh.f. "Asdreni"-Përshefc; Sh.f. "Faik Konica"-Dobrosht; Sh.f. "Ismail Qemali"-Nerasht dhe Sh.f. "Kiril Pejçinoviç"-Tearcë, si dhe 3 shkolla fillore periferike në fshatrat Nepreshten, Leshkë dhe Odër. Kulturën në komunën e Tearcës e përfaqësojnë disa shoqëri kulturo-artistike, si: SHKA "Ismail Qemali"-Nerasht; SHKA "Vëllazërimi"-Sllatinë; SHKA "Jehona"-Përshefc dhe SHKA "Teuta"-Tearcë.

Në sferën e shëndetësisë në këtë komunë funksionojnë 6 ambulanca si punkte të Shtëpisë Rajonale të Shëndetit-Tetova, disa ambulanca stomatologjike si dhe disa barnatore private.

Sa i përket sferës së mjedisit jetësor, komuna e Tearcës falë një donacioni të dhënë nga Ambasada e Suedisë ka arritur të përpiloj Planin Aksional Lokal Ekologjik.¹

¹ Profili i komunës së Tearcës- Dokument zyrtarë i komunës-v.2006

Akti i themelimit:-

Themelimi i komunave në R.M. rregullohet me Ligjin për organizimin territorial ku përcaktohen rajonet e komunave, emrat, selitë dhe kufinj të komunave. Në bazë të këtij ligji, më 20.12.1996 u rithemelua komuna e Tearcës si njësi e veçantë nga komuna e Tetovës.

Me këtë ligj përcaktohet lloji dhe emrat e vendbanimeve, rregullohet bashkëngritja; ndarja dhe ndryshimi i kufijve të komunave si dhe përcaktimi i kufijve kadastral të komunave.

Selia e komunës është në f.Tearcë, ndërsa kufiri i fshatit, si vendbanim, përcaktohet me planin e përgjithshëm për vendbanimin.

Kufinj të komunës janë kufijtë e komunave kadastrale të vendbanimeve në pjesën që kufizohet me komunën fqinje ose përputhen me kufirin shtetëror të Republikës së Maqedonisë.

Gjithashtu, komuna obligohet të paraqes ekstraktin nga evidenca për format e vetadministrimit vendor, pas themelimit të tyre në Ministrinë për vetëqeverisje lokale dhe të mban evidencën për format e vetadministrimit vendor që janë themeluar në rajonin e saj.²

Organizimi i brendshëm i komunës së Tearcës:-

Organizimi dhe përcaktimi i organizimit, kompetencat dhe mënyra e kryerjes së detyrave të administratës komunale bëhet me vendim të sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Tearcës të cilin e propozon Kryetari i komunës.

Statuti është akt themelor i komunës me të cilin përcaktohen çështjet themelore lidhur me organizimin dhe punën e komunës dhe me çështje të tjera të rëndësishme për komunën.

Organizimi i brendshëm i administratës së komunës së Tearcës mbështetet në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.³

Me këtë Rregullore përcaktohet numri i punonjësve të nevojshëm për kryerjen e punëve në kompetencë të administratës së komunës së Tearcës, emërtimi, renditja dhe përshkrimi i vendeve të punës si dhe kushtet e nevojshme për kryerjen e punëve dhe të detyrave.

Punët dhe detyrat që kryhen në komunë grupohen sipas karakterit, duke u nisur nga ngjajshmëria e tyre e ndërsjelltë, lidhshmëria dhe lloji, vëllimi dhe shkalla e ndërlikueshmërisë, përgjegjësisë, profesionalizmit të nevojshëm dhe të kushteve tjera për kryerjen e tyre.

Administrata komunale organizohet në sektorë dhe departamente. Administratën komunale e përbëjnë sektorët vijues: Sektori për punë të përgjithshme administrative, për çështje normative-juridike, shërbime shoqërore dhe publike, Sektori për urbanizëm, mbrojtje të ambientit jetësor, komunikacion,

² "Ligji për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në R.M." - ("Gazeta zyrtare e R.M" nr. 55/2004).

³ "Ligji për vetadministrim lokal i R.M." - ("Gazeta zyrtare e R.M" nr. 05/2002).

rrugë dhe veprimtari botore dhe Sektori për financa, buxhet, administrim me të hyra dhe zhvillim ekonomik lokal.

Sektorit për çështje normative-juridike dhe punë të përgjithshme administrative, përbëhet nga dy departamente, edhe atë: Departamenti për punë normativo-juridike Departamenti për punë administrative.

Sektorit për punë shoqërore dhe publike si dhe informim, komunikim, protokol dhe organizim, përbëhet nga dy departamente, edhe atë: Departamenti për shërbime publike dhe shoqërore, Departamenti për informim, komunikim, protokol dhe organizim.

Sektorit për urbanizëm, mbrojtje të ambientit jetësor, shërbime komunale, komunikacion dhe rrugë, përbëhet nga tre departamente, edhe atë: Departamenti për urbanizëm, Departamenti për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe Departamenti për veprimtari komunale, komunikacion dhe rrugë.

Sektorit për financa, buxhet, administrim me të hyra, përbëhet nga dy departamente, edhe atë: Departamenti për financa dhe buxhet, Departamenti për tatime lokale dhe taksa komunale.

Sektorit për zhvillim ekonomik lokal, përbëhet nga dy departamente, edhe atë: Departamenti për zhvillim ekonomik lokal të brendshëm dhe Departamenti për zhvillim ekonomik regjional dhe ndërkombëtar.

Si Departamente të veçanta në kuadër të organizimit të brendshëm të komunës së Tearcës janë: Departamenti për menaxhim me resurse njerëzore, Departamenti për inspektim mbykqyrës-inspektorati dhe Departamenti për revizion të brendshëm.

Për organizimin e brendshëm të administratës së komunës së Tearcës është përgjegjës Kryetari i komunës. Komuna e Tearcës ka të emëruar edhe Sekretar të komunës i cili e organizon, koordinon, bashkërendit dhe orienton kryerjen e punëve dhe detyrave në administratën komunale dhe kujdeset për ligjshmërinë, efikasitetin, funksionimin dhe metodat e punës së administratës komunale si dhe udhëheq me grupin menaxhues të komunës⁴.

Qytetarët janë shfrytëzuesit e drejtëpëdrejt të shërbimeve të cilat duhet t'i ofroj komuna. Gjatë zgjedhjeve, qytetarët e zgjedhin Kryetarin e komunës dhe këshilltarët ku u japin atyre besimin për t'u shërbyer interesave të përgjithshme, e jo atyre individuale.

Paratë e taksapaguesve e bëjnë të mundur funksionimin e komunës, punësimin e nëpunësve shtetëror dhe të punësuarëve tjerë. Përgjegjësia e udhëheqësve të komunës për të shpenzuar të hollat e taksapaguesve është shumë e lartë.

Komuna është e obliguar të jep llogari për përpjekjet dhe rezultatet e punës dhe aktiviteteve të tyre. Qeverisja e mirë, transparenca dhe integriteti janë gurrëthemelet e organizatës komunale. Vetëdija e obligimeve ndaj qytetarëve

⁴ Statuti i komunës së Tearcës ("Fletorja zyrtare e komunës së Tearcës", nr.03/2007)

është aftësia kryesore e të gjithë të zgjedhurve dhe punëtorëve profesionist brenda komunës.

Secila organizatë, përfshirë këtu edhe komunën, është përzierje e strukturës dhe kulturës. Struktura nënkupton formën, rregullat, përgjegjësitë e qarta, autoritetet dhe detyrat; përcaktime të qarta këto të cilat janë të lidhura me cilësinë, përpjekjet dhe komunikimin.

Kultura nënkupton vëmendje ndaj të punësuarëve, vlerave ndjenjave, motivimin dhe demotivimin. Komunikimi i brendshëm është gjaku i një organizate dhe paraqet shkakun themelor të të suksesit në organizatë.


Për të arritur një komunikim të mirëfilltë brenda administratës, në komunën e Tearcës çdo fillim jave planifikohet plani i punës. Gjithmonë mbahen mbledhje në të cilat planifikohen punët që do të kryhen.

Komunikimi i brendshëm:-


Komunikimi është vaji i motorit të organizatës! Pa komunikim organizata bllokohet dhe të punësuarit ndahen në disa ishuj të individëve ose grupe të vogla të punëtorëve. Kur një qytetarë futet në komunë dhe i shikon të gjitha dyert e mbyllura dhe vëren se nuk ka aktivitete brenda saj, shpeshherë ekziston përfundimi se në atë institucion nuk ka komunikim të mirë.

Në komunën e Tearcës komunikimi zhvillohet në katër nivele, edhe atë duke respektuar përmbajtjen, procedurën, interaksionin dhe ndjenjën. Kjo mund të shihet në figurën e mëposhtme.

Për të pasur komunikim konstruktiv duhet që të respektohet bashkëbiseduesi dhe të shihet se personat që komunikojnë a janë të një niveli të barabartë.



Struktura organizative:-rezulton nga procesi i organizimit brenda sektorit.Struktura organizative është sistem i raporteve formale të përcaktuara dhe joformalisht të zhvilluara që udhëheq aktivitetet e të punësuarëve në sektor.Figurativisht struktura organizative paraqitet si vijon:



Struktura organizative definohet si:

- ↪ shumë e detyrave formale të ndara ndaj nëpunësve shtetëror;
- ↪ raporte të informatave formale duke kyçur autoritetet lineare, përgjegjësi për vendimet në mes niveleve hierarkike dhe distancë të kontrollit të udhëheqësit;
- ↪ planifikim dhe sistem i cili siguron koordinim efikas në mes të punësuarve në sektor.


Misioni i komunës së Tearcës:-

Komuna e Tearcës planifikon shumë aktivitete lidhur me kapacitetet njerëzore dhe ekonomike. Qëllimi i politikës menaxhuese të komunës së Tearcës është që të jenë real gjatë krijimit të ekipit adekuat të udhëheqësve dhe të punësuarëve për t'i zhvilluar planet dhe qëllimet e organizatës.

Komuna e Tearcës ka qëllimet afatgjate dhe afatshkurtëra të cilat parasegjithash varren nga kapacitetet njerëzore (profesionale), kapacitetet ekonomike, planet strategjike dhe mundësitë reale.

Komuna e Tearcës në përpilimin e misionit të saj është udhëhequr nga “Modeli Kaskadë” i cili paraqet mjet për t'i bërë reale dhe praktike marrëveshjet midis menaxhmentit (Kryetarit, sekretari) dhe Këshillit komunal. Kriter i rëndësishëm është qasja ndaj buxhetit, pajisjeve teknike dhe hapsirës për punë.

Modeli Kaskadë e lidh misionin e komunës me përpjekjet individuale dhe arritjet e të gjithë personave të cilët punojnë në komunë.⁵



Këshilli komunal dhe Kryetari i komunës janë përgjegjës për misionin e komunës të bazuar në premtimet që ua kanë dhënë qytetarëve të tyre.

Kryetari i komunës dhe udhëheqësit e departamenteve zhvillojnë planin vjetor të departamenteve të bazuar në ide reale. Secili udhëheqës adopton planin vjetor në departamentin e tij me qëllime të qarta dhe të definuara në mënyrë specifike. Në fakt, plani vjetor i departamenteve dhe plani i personelit paraqesin

⁵ Udhëzues për menaxhim me resurset njerëzore në komunën e Tearcës.

kontratë midis udhëheqësit të departamentit dhe Kryetarit të komunës në përpilimin e misionit të komunës.

Duke u bazuar te njohuritë e nëpunësve shtetëror, udhëheqësi i departamentit zhvillon plan individual të karrierës për çdo të punësuar i cili paraqet pikënisje për stimulimin e nëpunësit shtetëror.⁶


Udhëheqje e mirë:-

Qeverisje e mirë nënkupton shpenzimin e të hollave të taksapaguesve të mënyrë të duhur dhe transparente dhe shmangien e dukurisë së quajtur korrupsion. Kodi etik shërben si dorezë e dobishme “kur shkallët janë të rrëshqitshme”. Kodi i sjelljes është kod i nëpunësve shtetëror dhe përfaqësuesve të zgjedhur në të cilin përcaktohen “rregullat e lojës”.

Këshilli i komunës së Tearcës ka dhënë Pëlqim për Kodin etik të përpiluar nga UNDP dhe BNJVL dhe të njëjtin e ka vënë në zbatim.

Për të arritur qeverisjen e mirë duhet që të respektohet mendimi i tjetrit sepse kështu mund të diskutohen barrierat e mundshme në komunë, rekomandime për Kryetarin e komunës, sekretarin, udhëheqësit, nëpunësit shtetëror, etj.

Suksesi i komunës varret nga: profesionistët (njerëzit), strategjia, mjetet teknike dhe buxheti. Kjo figurativisht paraqitet në tavolinën e mëposhtme.



Udhëheqja në kuptimin e përgjithshëm të fjalës ka këto sinonime: vendosje, rregullim, planifikim, organizim, drejtim, arritje e qëllimeve, realizim si dhe dominim, manipulim, pësim, mashtrim, etj.

Udhëheqja paraqet procesin përmes të cilit grupi i zgjedhur i njerëzve i drejton dhe orienton të gjithë të punësuarit në organizatë, (që në rastin konkret kemi të bëjme me komunën e Tearcës) sipas detyrës së përbashkët për qëllim të përbashkët.

Sipas Mas-it dhe Dagllas-it, udhëheqja paraqet procesin e orientimit të vetëdijshëm të aktiviteteve njerëzore kah realizimi i qëllimeve të caktuara,


⁶ Udhëzues për komunat e R.M. “Menaxhimi me reserset njerëzore” fq. 15, v.2007.

përkatësisht tërësinë e ndërlidhur të pesë funksioneve: planifikimit, organizimit, kuadrit (personelit), udhëheqjes dhe kontrollit.

Nëse i analizojmë të gjitha këto sinonime, vijmë në përfundim se këto përfshijnë: rregullimin, planifikimin, kontrollin, organizimin, drejtimin apo realizimin.

Mbështetur në kuptimin e plotë dhe mjaft kompleks të menaxhimit si proces apo aktivitet, atë mund t'a definojmë si tërësi aktivitesh që realizohet përmes disa funksioneve me qëllim që në mënyrë efikase të sigurojë, të shpërndajë dhe të shfrytëzoj potencialin njerëzor dhe resurset fizike që të arrijë qëllimin e përcaktuar.

Në mënyrë skematike procesin e menaxhimit mund ta paraqesim në këtë formë:



Nga kjo që thamë më lartë mund të nxjerrim se funksionet kryesore që e përbëjnë esencën e udhëheqjes brenda një sektori janë: planifikimi, organizimi, kuadri (personeli), udhëheqja dhe kontrolli.

Përgjegjësia, detyrat e udhëheqësit dhe nëpunësit:-

Kontrata e punës është marrëveshje e përbashkët midis udhëheqësit dhe punëtorit. Që të dy kanë përgjegjësi dhe detyra për realizimin e qëllimeve strategjike të komunës të bazuara në komunikim, respekt dhe mirëbesim. Udhëheqësi është në nivel më të lartë të hierarkisë sesa nëpunësi. Kjo nënkupton se udhëheqësi vendos nëse mundon marrëveshja mes dy palëve. Udhëheqësi nuk është vetëm shef i punëtorit, por ai është edhe mbykqyrës dhe udhëheqës për ta shoqëruar punëtorin që t'i jap rezultate më të mira që mundet dhe për ta përkrahur atë drejt zhvillimit të tij dhe karrierës së tij.

Bashkëpunimi midis udhëheqësit dhe punëtorit bazohet në kontributin e tyre për komunën dhe përgjegjësitë e ndryshme të tyre. Udhëheqësi përfaqëson komunën dhe është shef, ndërsa punëtori ka kontratë për ta kryer punën e tij dhe për të marrë pagë për punën e kryer. Stili i lidhësit ka dy anë, të stimuloj dhe ta korrigjoj punëtorin. Në përgjithësi përdorimi i metodës së “mjaltit” funksionon më mirë se sa metoda e “uthullës”, edhe pse ndonjëherë udhëheqësi duhet të jetë më i ashpër nëse punëtori nuk dëshiron t'u përmbahet rregullave.

Udhëheqësi i rekomandon punëtorit të tij	Punëtori i jep udhëheqësit të tij
Punë siç është përshkruar në vendin e punës dhe planin vjetor të komunës.	Kryerje të punës sa në mënyrë më profesionale.
Instruksione të qarta.	Cilësi.
Leje për të shpërblyer punëtorin.	Vlerësim të përpjekjeve dhe rezultateve të veta.
Kushte të mira për punë.	Rrespekt ndaj rregullave të komunës.
Këshilla dhe përkrahje kur has në probleme.	Besim tek udhëheqësi.
Besim i bazuar në qeverisjet të mirë dhe kodin etik.	Rrespekt ndaj kodit etik, transparencë në punë, integritet dhe moral të lartë.
Vlerësim të performancës, këshilla për karrierë dhe zhvillim profesional.	Raporton udhëheqësin lidhur me praktikën jo të drejtë të komunës.

Në këtë rast udhëheqësi nuk mund të paraqitet vetëm si shef, por në menaxhimin me resurset njerëzore moderne ai gjithashtu i udhëzon punëtorët e sektorit që ata të japin rezultate më të mira, përkrah ata të ngrisin profesionalisht vetveten dhe karrierën e tyre.

Si duhet të jetë udhëheqësi:



Politika kadrovike brenda sektorit:-

Zgjedhja e personelit profesional paraqet aktivitetin e definuar të udhëheqësit që përfshijnë përcaktimin e qartë të raportit midis aktiviteteve dhe autoritetit.

Aktiviteti i zgjedhjes së personelit brenda sektorit në komunën e Tearcës, përfshijnë:

- ↳ definimin e nevojave për personel profesional (përcaktimin e numrit të personelit të nevojshëm si dhe kualifikimin përkatës);
- ↳ përcaktimin e burimeve për personel (njohjen e burimeve të kuadrit të nevojshëm);
- ↳ zgjedhjen e personelit (nga personeli potencial të zgjedhen ata të cilët do të punojnë profesionalisht në sektor dhe të cilët do të kryejnë detyrat e caktuara).

Definimi i nevojave për personel:- paraqet aktivitetin planifikues të udhëheqësit dhe njëkohësisht hapin e parë të politikës së kuadrove nga fusha e menaxhmentit. Në rastin e definimit të nevojave për kuadër menaxheri duhet të jetë në gjendje për t'i njohur këta tregues:

- ↳ punët e nevojshme që duhet të kryen ashtu që të realizohen qëllimet e komunës;
- ↳ aftësitë e nevojshme të personelit për të kryer këta punë;
- ↳ numrin e nevojshëm të personelit.

Aktiviteti i zgjedhjes së personelit është i mundshëm vetëm në qoftë se bazohet në mjetet e nevojshme të cilat janë edhe si pjesë përbërëse të politikës së kuadrove.

Analiza e punëve paraqet procesin e mbledhjes, analizimit të punëve dhe identifikimit.

Përshkrimi i punëve është përmbajtja e shkruar e obligimeve dhe përgjegjësiave për një vend pune. Kjo përfshijnë emërtimin e punëve, personelin përkatës të cilit punëtori duhet t'i jap raport për punën e tij, si dhe obligimet e tjera të cilat dalin nga puna.

Specifikimi i punës përfshijnë përcaktimin e bazave të nevojshme sipas të cilave zgjedhet-kërkohet personeli. Kjo përfshijnë arsimimin, përvojën dhe aftësitë fizike-mendore.

Përcaktimi i burimeve të kuadrit:-Burimet për kuadër të nevojshëm mund të jenë të brendshme dhe të jashtme. Burimi i brendshëm për kuadër është komuna apo subjekti ekzistues, sektori. Kuadri nga burimet e jashtme mund të shfrytëzohet nga të gjitha nivelet organizative dhe një gjë e tillë kërkohet atëherë kur aftësitë e nevojshme të kuadrove janë të pamjaftueshme brenda komunës. Burimet e jashtme mund të jenë të natyrave të ndryshme duke filluar nga agjencitë për punësim, byrotë, qoftë shtetërore apo private, etj.

Zgjedhja e personelit:-përfshijnë procesin e zgjedhjes së personelit më të kualifikuar të duhur për punët përkatëse. Menaxheri gjatë procesit të zgjedhjes duhet të ketë në dispozicion tërë shërbimin e kuadrove, i cili mund t'i ofrojë ndihmë qoftë në inçizimin, anketimin e kuadrit potencial të ofruar. Në qoftë se këtë nuk mund që t'ia ofrojë shërbimi i kuadrove brenda organizatës, atëherë mund të shfrytëzojë edhe shërbime tjera të përgjithshme të specializuara jashtë organizatës.

Suksesi:-

Ndryshimet në komunën e Tearcës i përkasin ritmit të secilës ditë. Ndryshimet janë një kombinim i kohës dhe aksioneve për të ndryshuar njohuritë, qëndrimin, sjelljen individuale në krijimin imaxhit të mirë për komunën.

Udhëheqësit e komunës e kanë kuptuar se qeverisja e mirë nënkupton cilësinë e “administratës publike” dhe në këtë mënyrë mund të stimulohet zhvillimi ekonomik dhe prosperiteti i shoqërisë.

Në aspektin e organizimit të brendshëm, si suksese të komunës së Tearcës mund të llogariten: mirëbesimi dhe udhëheqja e bazuar në sinqeritet dhe transparencë; sistematizim i ri i vendeve të punës “punës t’ia gjejmë njeriun dhe jo njeriut t’i gjejmë punë”; bashkëpunim të shkëlqyer për sa i takon zhvillimit të politikës së departamenteve; përpilim të planit vjetor të komunës dhe planeve operative vjetore të departamenteve; notim të nëpunësve shtetëror dhe sistem i vlerësimeve periodike për përpjekjet dhe rezultatet; respektim të dallimeve kulturore, etnike apo fetare, që konsiderohen si përparësi të kësaj komune; shmangie të ndikimeve politike për sa i përket zgjidhjes së problemeve lokale “më pak patriotizëm dhe ndikim politik në zgjidhjen e problemeve lokale”, etj.

Procesi i vendimmarrjes:-

Këshilli i komunës së Tearcës është institucioni më i lartë vendimmarrës në komunë. Këshillin e komunës së Tearcës e përbejnë 19 anëtarë të zgjedhur përmes votës së lirë të qytetarëve. Kryetari i Këshillit zgjedhet nga rradhët e anëtarëve të Këshillit me propozim të Komisionit kandidues. Ai mund të zgjedhet me votim publik nëse Këshilli nuk vendos që votimi të jetë i fshehtë.

Kryetari i Këshillit kujdeset për organizimin e punës së Këshillit; për zbatimin e Rregullores së Këshillit dhe jep sqarime në lidhje me zbatimin e saj; për sendërtimin e të drejtave të anëtarëve të Këshillit; për zbatimin e parimit për punë transparente të Këshillit.

Ai i nënshkruan Vendimet dhe aktet e Këshillit dhe më pas ia dorëzon Kryetarit të komunës për shpallje dhe proklamim.

Këshilli vendos me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm të në, së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit. Statuti, buxheti, llogaria përfundimtare e buxhetit dhe rregullorja e punës së Këshillit miratohen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Votimi në Këshill mund të jetë i hapur dhe i fshehtë. Votimi i hapur në Këshill bëhet me ngritjen e dorës dhe me deklaram individual. Deklarimi individual mund të bëhet atëherë kur këtë do ta kërkojë një anëtarë i Këshillit me mbështetjen e 4 anëtarëve të tjerë. Votimi individual bëhet me deklaramin e çdo anëtari të thirrur të Këshillit “për” ose “kundër” propozimit ose me “përmbajtje” nga votimi.

Votimi i fshehtë në Këshill bëhet me fletëvotime ku secili fletëvotim duhet të jetë në të njëjtën madhësi dhe ngjyrë.⁷

Organet e komunës së Tearcës gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre sjellin akte të përgjithshme dhe akte të veçanta.

Me aktet e përgjithshme në mënyrë burimore rregullohen marrëdhëniet, të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe personave juridik në suaza të kompetencave të komunës. Ata përmbajnë norma të përgjithshme juridike që kanë të bëjnë me numër të pakufizuar të rasteve.

Organet e komunës së Tearcës sjellin edhe akte të veçanta kur vendosin në procedurë administrative ose kur bëhet zgjedhje apo emërim i personave, si dhe raste të parapara me ligj ose dispozitë tjetër.

Si akte të përgjithshme që sjell Këshilli i komunës së Tearcës janë: statuti, programet, planet, vendimet dhe dispozitat tjera.

Procedura për miratimin e akteve të përgjithshme fillon me paraqitjen e propozimit për miratimin e aktit të përgjithshëm.

Propozim për miratimin e aktit të përgjithshëm mund të japin: anëtarët e Këshillit; trupat punuese të Këshilli dhe 10% zgjedhës nga komuna.

⁷ Rregullore e Këshillit të komunës së Tearcës (“Fletorja zyrtare e komunës së Tearcës”, nr.04/2005)

Propozim për miratimin e aktit të përgjithshëm nga kompetenca e Këshillit e përcaktuar me Statutin e komunës, e japin Kryetari i komunës, organi drejtues, trupi punues i Këshillit ose shërbimet publike, institucionet dhe ndërmarrjet që i themelon Këshilli i komunës. Propozimi për miratimin e aktit duhet të përmbajë bazën juridike për miratim dhe shkaqet për të cilat duhet të miratohet.

Propozimi për miratimin e aktit të përgjithshëm mund t'i jepet Kryetarit të Këshillit në formë të shkruar ose gojarisht në seancë.

Propozimi për miratimin e aktit i dorëzohet trupit punues përkatës ose organit kompetent në afat prej 3 ditë nga dita e dhënies së tij dhe më pas ky propozim i dorëzohet Kryetarit të komunës.

Këshilli i komunës e shqyrton propozimin për miratimin e aktit të përgjithshëm me qëndrimin e trupit punues ose organit drejtues dhe e përcakton arsyeshmërinë dhe nevojën për miratimin e aktit. Nëse Këshilli vlerëson se nuk ka bazë dhe nevojë për miratimin e aktit, për këtë e informon propozuesin.

Kur Këshilli i komunës së Tearcës do ta përcaktojë arsyeshmërinë dhe nevojën për miratimin e aktit të përgjithshëm, automatikisht cakton përpilues të aktit dhe nëse me propozimin për miratim është dorëzuar edhe propozimi i aktit, Këshilli bën diskutim për miratimin e të njëjtit.

Këshilli i komunës së Tearcës programet, vendimet dhe aktet tjera i miraton në procedurë të përcaktuar me ligj dhe Statutin e komunës.

Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve miratohen me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në raste të veçanta, Këshilli ndjek edhe procedurë urgjente për marrjen e vendimeve nëse kjo është e domosdoshme për të penguar fatkeqësitë elementare, rrethanat tjera të jashtëzakonshme ose kur është me interes për sendërtimin e funksioneve të komunës.

Gjithashtu, me Rregulloren e Këshillit të komunës së Tearcës rregullohet edhe interpretimi autentik i akteve të përgjithshme. Kërkesë për interpretim autentik të aktit mund të bëjnë anëtarët e Këshillit, 10% të zgjedhësve në komunë, ndërmarrjet publike që ushtrojnë veprimtarinë e saj në territorin e komunës së Tearcës, etj.⁸

Rregullat, vendimet dhe aktet tjera të Këshillit shpallen në "Fletoren zyrtare të komunës së Tearcës".

Vendimet dhe aktet tjera të miratuara nga Këshilli i komunës hynë në fuqi ditën e tetë nga e dita e shpalljes në "Fletoren zyrtare të komunës".

Rregullat e Këshillit mund të hyjnë në fuqi edhe në afat më të shkurtër se tetë ditë nëse: shkaqet për të cilat propozohet nxjerrja e rregullave dhe qëllimet që dëshirohet të arrihen me nxjerrjen e tyre janë të karakterit urgjent dhe të pashtyeshëm; nuk krijojnë obligime materiale për qytetarët dhe subjektet juridike; çështjet që rregullohen janë nga sfera e mbrojtjes dhe shpëtimit e të ngjashme;

⁸ Rregullore e Këshillit të komunës së Tearcës ("Fletorja zyrtare e komunës së Tearcës", nr.04/2005)

atë i imponojnë parimet e racionalitetit, efikasitetit, ekonomizimit, operativitetit e të ngjashme.

Administrata komunale mban përmbledhje të akteve të publikuara, të miratuara dhe të ekzekutuara nga ana e organeve të komunës së Tearcës. Aktet evidentohen sipas emërimit të tyre. Kjo d.t.th. se ndaras evidentohen planet dhe programet nga vendimet dhe llojet tjera të akteve që janë sjellur. Në përmbledhje gjendet teksti i plotë i aktit, me numër dhe datë të sjelljes së tij si dhe numri i "Gazetës zyrtare të komunës" në të cilën është publikuar. Poashtu evidentohen të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kryera ndaj akteve.

Qytetarët në çdo kohë mund të parashtrojnë kërkesë dhe të marrin informatat e duhura lidhur me miratimin dhe ekzekutimin e akteve të përgjithshme dhe të veçanta.

Qasja ndaj opinionit (transparenca):- Qytetarët e komunës së Tearcës në mënyrë të rregullt informohen për vendimet që i miraton Këshilli i komunës; mënyrën dhe kushtet për realizimin e të drejtave të qytetarëve; obligimet e qytetarëve që dalin nga kompetencat e vetëqeverisjes lokale; planet, projektet dhe programet që janë në përgatitje e sipër dhe që paraqesin rëndësi për zhvillimin e komunës; shërbimet që i marrin nga administrata e komunës; të ardhurat që realizohen në komunë dhe mënyrën e shpërndarjes dhe shpenzimit të tyre; furnizimet publike; emërimin e drejtorëve dhe përfaqësuesve në këshillat drejtuese të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike si dhe informata të tjera që dalin nga kompetencat e organeve të komunës në pajtueshmëri me ligjin.

Informimi i qytetarëve bëhet në mënyrë të rregullt, pa kompenzim edhe atë përmes: botimit të fletorez zyrtare të komunës; botimit dhe distribuimit deri te qytetarët të buletineve mujore informative; të tabelave të shpalljes (në hapësirat e komunës); veb sajteve (web sites); tribunave publike; mjeteve të informimit dhe mënyrave tjera adekuate më të volitshme për informimin e opinionit.

Në komunë sigurohet e drejta e qasjes së lirë në informatat me karakter publik me të cilat posedojnë organet e komunës (Këshilli dhe Kryetari i komunës), ndërmarrjet dhe institucionet publike të themeluara nga komuna si dhe subjekte juridike dhe fizike që kanë kompetenca publike të besuara nga komuna.

Listën e informatave me karakter publik për organet e komunës e propozon Kryetari i komunës kurse e përcakton Këshilli. Listën e informatave me karakter publik për ndërmarrjet dhe institucionet publike të themeluara nga komuna e përcakton Këshilli drejtues me propozimin e drejtorit. Qasja e lirë në informatat realizohet në afatin e caktuar ligjor, edhe atë: me shikimin e dokumenteve të cilat i posedon poseduesi i informatave; me marrjen e duplikatit, fotokopjes apo shënimit elektronik nga dokumentet të cilat i posedon poseduesi i informatave.⁹

⁹ Statuti i komunës së Tearcës ("Fletorja zyrtare e komunës së Tearcës", nr.03/2007)

Qeverisja elektronike:-

Qeverisja elektronike është një nga komponentët kryesorë e cila mundëson prokurimin elektronik, dorëzimin elektronik të tatimeve dhe regjistrimin elektronik për bizneset. Qeverisja elektronike ofron sisteme të administrimit publik që përfshijnë pagesat dhe rishikimet e tatimeve edhe në kushte të vështira. Ky sistem është një produkt fleksibël që shërben si burim i hapur për të gjithë, si dhe ofron të gjitha mundësitë maksimale të Internetit, ku nëpërmjet Microsoft Internet Explorer, lehtësohet komunikimi me të gjitha ministritë dhe komunat me një kosto shtesë mjaft të ulët.

Qeverisja elektronike është domosdoshmëri e kohës dhe është dëshmuar se ajo krijon efikasitet më të madh në shërbimet ndaj qytetarëve, prandaj si e tillë duhet të zërë vend në prioritetet e secilit institucion.

Teknologjia e digjitalizimit të të dhënave përveç shpejtësisë dhe efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve, krijon edhe raporte transparente të institucioneve si dhe ndikon në uljen e shkallës së korrupsionit dhe të keqpërdorimeve të ndryshme gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Qeverisja elektronike synon të arrijë tre objektiva: Efikasitetin dhe krijimin e një administrate efikase dhe profesionale; Transparencën e plotë të qeverisjes dhe vendimmarrjes politike dhe Krijimin e një sistemi digjital të të dhënave dhe shërbimeve për qytetarët.

Rregullativa ligjore në sferën ekonomike:-

Ligji për financimin e komunave:- Me këtë ligj rregullohet financimi i njësive të vetadministrimit lokal. Si të ardhura burimore të komunës parashihen tatimi personal, një pjesë të TVSH-së si garancë për funksionimin e komunave në realizimin e kompetencave që rrjedhin nga ligji për vetëqeverisje lokale. Si burime vatjake të të hyrave janë: tatimet, taksat dhe kompenzimet lokale, të hyrat nga prona, vetkontributi, dënimet me para, donacionet dhe të hyrat tjera të rregulluara me ligj.

Në tatimet lokale bëjnë pjesë:

- Tatimi mbi pronën;
- Tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën;
- Tatimi mbi qarkullimin e paluajtshmërive.

Taksa lokale të përcaktuara me ligj janë:

- Taksat komunale;
- Taksat administrative;

Kompenzimet lokale të përcaktuara me ligj janë:

- Kompenzimi për rregullimin e tokës ndërtimore;
- Kompenzimet nga veprimtaria komunale;
- Kompenzimet për plane hapsinore dhe urbanistike.

Të hyrat nga pronësia:

- Të hyrat nga qiraja;
- Të hyrat nga kamata;
- Të hyrat nga shitja e pronës;
- Të hyrat nga dotaciones;
- Të hyrat nga dënimet me para;
- Të hyrat nga vetkontributi.

Me këtë ligj është rregulluar edhe tatimi mbi të ardhurat personale, ku komunat realizojnë të hyra nga ky tatim.

Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale të paguara gjatë vitit në vijim shpërndahen nëpër komuna, edhe atë:

- 3% nga tatimi mbi të ardhurat personale të të ardhurave vetjake nga rrogat e personave fizik të paguara në komunën në të cilën janë të paraqitur me vendbanim dhe qëndrim të përhershëm.
- 100% nga tatimi mbi të ardhurat personale nga personat fizik, të cilët merren me veprimtari zejtare.

Buxheti është Plani vjetor për financimin e kompetencave të komunës, i cili përbëhet nga vlerësimi vjetor i të hyrave sipas burimeve dhe të dalave sipas destinimeve.

Sipas këtij ligji, shfrytëzues komunal të buxhetit janë organet e komunës dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna.

Ky ligj parasheh taksat lokale me të cilat nënkupton kompenzim në para për shërbimet dhe të drejtat të cilat organet komunale ua japin personave juridik dhe fizik, lartësinë e së cilës e përcakton komuna.

Gjithashtu, me Ligjin për financimin e komunave parashihen edhe dotacionet, të cilat paraqesin transfer nga Buxheti i R.M. dhe buxhetet e fondeve tjera në buxhetin e komunës.

Ekzistojnë disa lloje të dotacioneve, si: dotacion i destinuar, dotacion kapital, dotacion për kompetencë të deleguar, bllok dotacion, etj.

Kur jemi te Ligji për vetëqeverisje lokale, patjetër duhet të theksojmë se e gjithë rregullativa që i përket sferës komunale, si: planifikimi hapsinor, sjellja e planeve urbanistike (plani i përgjithshëm urbanistik) dhe marrja (dhënia) e dokumentacionit të nevojshëm, kalon në kompetencë të vetëqeverisjes lokale.

Decentralizimi fiskal sipas këtij ligji zbatohet në faza dhe nënkupton vendosjen e mekanizmave për financimin e komunave që është transparente dhe e bazuar në kritere dhe masa objektive.

Qasja në fazën e decentralizimit fiskal bazohet në parimet vijuese:

- transferin gradual të kompetencave në pajtim me kapacitetin e komunave për marjen e këtyre kompetencave;
- sigurimin e drejtë dhe adekuat të mjeteve për kryerjen efikase dhe pa pengesa të kompetencave;
- zvogëlimin e mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe fondet për funksionet të cilat do të transferohen në kompetencë të komunave.¹⁰

Ligji për taksat komunale:- I jep të drejtë Këshillit komunal që vet të caktojë lartësinë e taksës komunale. Taksat komunale paguhen sipas Tarifës për taksa komunale e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji.

Taksat komunale paguhen për:

- secilin lokal afarist;
- shfrytëzimin e sipërfaqeve si kampe për ngritjen e ombrellave;
- shfrytëzimin e hapsirës para lokalit afarist për kryerjen e veprimtarisë;
- vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike;
- shfrytëzimin e shesheve për shitjen e sendeve, organizimin e ekspozitave;
- shfrytëzimin e hapsirës për parkimin e veturave, autobusëve;
- shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit Publik.¹¹

Detyrues ndaj taksës komunale është secili person fizik dhe juridik të cilët shfrytëzojnë të drejta të caktuara.

Të liruar nga taksa komunale janë institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike, institucionet publike, organizatat joprofitabile, njësitë ushtarake, etj.

¹⁰ Ligji për financimin e komunave ("Gazeta Zyrtare e R.M" nr. 61/2004)

¹¹ Ligji mbi taksat komunale ("Gazeta Zyrtare e R.M" nr. 61/2004)

Obligimi për pagimin e taksës komunale lind në çastin e shfrytëzimit të së drejtës, sendit ose shërbimit për të cilat është caktuar pagimi i taksës.

Kryetari i komunës, detyruesit të taksës komunale i lëshon vendim për lartësinë e taksës komunale.

Taksat komunale paguhen në shumë vjetore ose në përpjestueshmëri me kohën e shfrytëzimit të të drejtave. Taksa komunale paguhet çdo ditë dhe çdo muaj.

Taksat komunale paguhen sipas Tarifës komunale ku përfshihet në numrin tarifar.

Taksat komunale nuk caktohen në lartësi të njëjtë për të gjithë detyruesit të cilët kryejnë veprimtari ose profesion të njëjtë.

Lartësia e taksës nuk mund të përcaktohet sipas vlerës së sendit, qarkullimit të bërë ose të hyrave të realizuara, por ajo përcaktohet në mënyrë të ndryshme sipas llojit të veprimtarisë.

Sektori për Zhvillimi Ekonomik Lokal në komunën e Tearcës:-

Zhvillimi ekonomik lokal është proces në bazë të të cilit udhëheqësit lokal në kuadër të komunës punojnë së bashku me partnerët e sektorit publik, privat (biznesit) dhe joqeveritar me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për rritje ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Me këtë proces, ata vendosin dhe kultivojnë kulturë sipërmarrëse dinamike dhe krijojnë bashkësi të re dhe afarizëm prosperues me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetesës të të gjithë banorëve të komunës.¹²

ZhEL do të thotë që të punohet drejtëpëdrejt në ndërtimin e konkurrencës ekonomike në kushte tregu në nivel lokal me qëllim të përmirësimit të ardhmërisë së saj ekonomike. Me rëndësi të madhe është t'i jepet përparësi ekonomisë lokale dhe rritjen e konkurrencës së saj, sepse suksesi i bashkësisë sot varret nga përshtatja e tyre në rrethin tregtar që gradualisht ndërrohet dhe është gjithnjë e më konkurrent.

Që të ndërtohet konkurrenca, komuna e Tearcës ka arritur të përcaktojë anët e saj të forta, t'i largojë rreziqet, etj.

Për të definuar qëllimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal, komuna e Tearcës ka hartuar Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal.

Plani strategjik për zhvillim ekonomik të komunës së Tearcës paraqet një plan për ndërtimin e kapacitetit ekonomik të komunës, për përmirësimin e të ardhmes ekonomike të komunës dhe kualitetin e jetesës së qytetarëve të këtij territori, si dhe mundësinë për bashkëpunim të qëllimeve të ngjajshme zhvillimore, programeve dhe projekteve me komunat tjera fqinje.

Plani e definon vizionin e komunës, në fakt destinacionin përfundimtarë ku komuna parasheh zhvillimin ekonomik për 10 vitet e ardhshme. Drejtimi zhvillimor dhe politikat për zhvillim ekonomik për arritjen e vizionit, i caktojnë qëllimet afatgjate (strategjike) përmes realizimit të objektivave konkrete të cilat mund të maten.

Arritja e qëllimeve konkrete kryhet me identifikimin detal të programeve dhe projekteve nga ana e partneritetit për ZhEL të komunës së Tearcës dhe të gjitha palëve të interesuara. Qasja për hartimin e planit strategjik bëhet prej "lart-poshtë".

Në ndërtimin e procesit zhvillimor strategjik, si pikënisje është marrë analiza e situatës momentale ekonomike, resurset me të cilat disponon komuna si dhe aktet ligjore të cilat burojnë nga decentralizimi i pushtetit dhe strategjitë zhvillimore të Republikës së Maqedonisë.

Nga të gjitha të dhënat e grumbulluara nga SWOT analiza mund të sillen disa konkludime:

1. Pozita gjeografike konkurruese e komunës së Tearcës ka përparësi të rëndësishme dhe njëkohësisht edhe mundësi për zhvillim ekonomik. Në afërsi të

¹² Plani strategjik për zhvillim ekonomik lokal-komuna e Tearcës.

komunës kalon “korridori 8” dhe përmes komunës kalon edhe rruga regjionale për në Republikën e Kosovës (P-405).


2.Komuna e Tearcës tradicionalisht është komunë agreare ku bujqit dhe blegtorët nuk janë të bashkuar, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për teknologjitë e reja dhe standartet.

3.Komuna nuk do mundet për një afat më të gjatë të zhvillohet ekonomikisht pa tërheqjen e investimeve të huaja.

4.Komuna ka mundësi që të krijoj një pushtet lokal efektiv dhe efikas i cili do të krijoj rrethana të përshtatshme për sukses të bizneseve.

Vizioni i komunës së Tearcës për zhvillim ekonomik:-

Vizioni i komunës paraqet destinacionin e dëshiruar dhe drejtimet për zhvillim të komunës.Nga grafikoni i mëposhtëm qartë duket lidhshmëria mes politikave për zhvillim ekonomik (qëllimet strategjike) dhe qëllimi përfundimtarë i definuar (vizioni)- si destinacion atraktiv për biznes.



Qëllimet strategjike dhe konkrete për zhvillim ekonomik:-

Qëllimi strategjik është me rëndësi parimore për zhvillimin ekonomik lokal të komunës si vend rural. Në bazë të analizës së profilit të komunës dhe parasegjithash i udhëhequr nga SWOT analiza, prioritet për përkrahje të agrarit dhe zhvillimi i sektorit bujqësor, vendoset si dominues për këto arsye:¹³

- ↪ Qengji i Sharrit dhe djathi i fortë nga ky rajon është i njohur si në vend ashtu edhe jashtë tij, p.sh. në Itali;
- ↪ Shfrytëzimi i kullotave për zhvillim të blegtorisë (4.500 ha);
- ↪ Mundësi për zmadhimin e zhvillimit të prodhimtarisë së qumështit dhe mishit si dhe produkteve tjera;
- ↪ Mundësi për formimin e pikave grumbulluese dhe përpunimin e fruteve të malit (boronica, këpurdha, gështenja dhe bimëve shëruese);
- ↪ Brendimi i produkteve agrare p.sh molla tetovare, çaji i malit, mjalti, etj.;
- ↪ Mos ekzistimi i shoqatave prodhuese agrare dhe asociacioneve të biznesit;
- ↪ Mos ekzistimi i klasterëve, etj.

Nga këto arsye, për realizimin e këtij qëllimi afatgjatë strategjik, janë identifikuar disa qëllime afatshkurta dhe të matshme, edhe atë:

- ☞ Të formohen asociacione dhe shoqata të prodhuesve bujqësor, duke pasur parasysh edhe rreziqet dhe ndikimet negative nga rrethanat e jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none">• Numri i asociacioneve dhe shoqatave.• Numri i anëtarëve në shoqatë;• Numri i punëtorive të mbajtura;• Pjesëmarrja në punëtori.	<ul style="list-style-type: none">• Rregjistri qendror• Komuna• IAP – Tetovë• Anketa• Evaluime.	<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e mjeteve financiare për organizimin e punëtorive dhe seminareve• Shërbimet e shtrenjta nga konsumatorët e huaj.

¹³ Plani strategjik për zhvillim ekonomik lokal-komuna e Tearcës.

- ☞ Të zmadhohet numri i kapaciteteve përpunuese për prodhime agreare. Qëllimi i kësaj komponente është stimulimi i investimeve direkte për hapjen e reparteve prodhuese, duke pasur parasysh edhe rreziqet dhe ndikimet negative nga rrethanat e jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërmarrje të sapo formuara • Zona industriale • Numri i të papunëve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri qendror • Komuna • IAP – Tetovë • Agencia për punësim. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shkalla e lartë e kamatës, politika e pavoritshme kreditore, etj.

- ☞ Të promovohen brendet agrare: Si aktivitet themelor është hartimi i planeve të marketingut për hulumtimin dhe analizimin e mundësive për shitjen e brendeve agrare. Edhe ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje në medime • Shitja e prodhimeve agrare • Rritja e prodhimtarisë • Tatimi i fitimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri qendror • Komuna • IAP – Tetovë • Anketa. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mjeteve financiare për promovim dhe marketing.

- ☞ Organizimi i plasmanit të produkteve bujqësore përmes hapjes së tregut lokal. Për realizimin e këtij qëllimi do të shfrytëzohet modeli i Partneritetit Publik-Privat përmes lobimit. Edhe ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Shitja e produkteve agreare • Zmadhimi i prodhimtarisë • Tatimi i fitimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri qendror • Komuna • IAP – Tetovë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pronësia e lokacionit dhe tokës së përshtatshme për tregun lokal.

- ☞ Të organizohet shitja e produkteve bujqësore. Edhe ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Shitja e produkteve • Zmadhimi i prodhimitarisë • Tatimi i fitimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri qendror • Komuna • IAP – Tetovë • Ministria e Bujqësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pronësia e lokacionit dhe tokës së përshtatshme për qendër grumbulluese.

- ☞ Të promovohen kushtet për investim në bujqësi. Edhe ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Shitja e produkteve agreare • Tregjet vendase dhe të huaja • Investime. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • IAP – Tetovë • Anketa. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mjeteve financiare.

- ☞ Të përmirësohen kushtet për shfrytëzimin efikas të agrarit, përmes ndërtimit të infrastrukturës rrugore. Edhe ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Rekonstruimi i rrugëve lokale • Sipërfaqja e sistemit meliorativ. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Shoqata e bujqëve • Ministria për bujqësi. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mjeteve financiare.

Gjatë procesit të definimit të qëllimit strategjik për shfrytëzimin e resurseve malore janë marrur parasysh disa faktorë:

- ☞ Përqindjen më të madhe të territorit të komunës së Tearcës e mbulon Mali Sharr, si potencial i madh për zhvillim të turizmit malor;
- ☞ Mundësi për zhvillim të turizmit malor përmes gjuetisë;
- ☞ Revitalizimi i shtëpisë malore “Tre ujërat”;
- ☞ Tre liqene malore.

Nga këto arsye, si qëllim strategjik është shfrytëzimi i resurseve malore për zhvillimin e turizmit malor, ku si prioritet do të jetë ndërtimi i rrugëve të reja dhe rekonstruimi i atyre të vjetra. Ky qëllim strategjik ka tre qëllime afatshurtëra, edhe atë:

- ☞ Të përmirësohet dhe të zgjerohet infrastruktura rrugore për zhvillim më të shpejtë të turizmit. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i rrugëve të reja • Rekonstruimi i rrugëve lokale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Bashkësia lokale • Projekte kryesore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Burime të financave • Kushte të pavolitshme për ndërtimin e rrugëve.

- ☞ Të ndërtohen objekte të reja për zmadhimin e atraktivitetit turistik. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i objekteve të sapo ndërtuara • Numri i shtëpive malore të riparuar • Numri i turistëve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Bashkësia lokale • Agjencionet turistike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Burime të financave • Kushte klimatike për ndërtimin e shtëpive malore.

- ☞ Të promovohet turizmi malor, gjuetia. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Formimi i shoqatave për gjueti • Hapja e faqes së internetit • Marketingu. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Regjistri qëndror • Interneti. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mosrespektimi i rregullativës ligjore • Informim i pamjaftueshëm.

Si qëllim shumë i rëndësishëm strategjik është zhvillimi ekonomik nëpërmjet investimeve nga vendi, të huaja dhe nga mërgimtarët me ndërtim të marrëdhënieve partnere.

Ky qëllim strategjik është me rëndësi parimore për zhvillimin ekonomik të komunës. Nga ky qëllim strategjik janë identifikuar pesë qëllime konkrete të cilët çojnë drejt realizimit të këtij qëllimi të rëndësishëm afatgjatë.

- ☞ Të promovohet dhe afirmohet komuna si destinacion atraktiv i biznesit për tre vitet e ardhshme, përmes programeve për takim me mërgimtarët dhe informimi i tyre, si dhe lobimi për investim me mundësi të reja, etj. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> Investimet direkte nga mërgimtarët Punësime të reja Investime të huaja Mbajtja e konferencave. 	<ul style="list-style-type: none"> Komuna Regjistri qendror IAP-Tetovë Banka Popullore e R.M. 	<ul style="list-style-type: none"> Siguria e rajonit Informimi i pamjaftueshëm.

- ☞ Të krijohen kushte konkurruese për investim, përmes masave stimulative fiskale për sipërmarrës dhe biznes. Kjo është një masë direkte lokale fiskale për nxitjen e ndërmarrjeve dhe rritjes së investimeve të reja për nxitjen e punësimit. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> Zvogëlim i tatimeve komunale Tatime të zvogëluara Punësime të reja Firma të reja. 	<ul style="list-style-type: none"> Komuna Regjistri qendror IAP-Tetovë Agjencia për punësim. 	<ul style="list-style-type: none"> Pengesa ligjore gjatë implementimit.

- ☞ Të hapet qendër informative për biznes (promovim, dhënie të informacioneve ndaj investitorëve) përmes hapjes së zyrës për informim të qytetarëve. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i shërbimeve % e informimit • Llojet e informatave • Numri i shfrytëzuesve të shërbimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Anketa nga firmat dhe afaristët. 	<ul style="list-style-type: none"> • Burimet financiare për realizimin e qëllimit.

☞ Të hapet biznes inkubator për përpunimin e produkteve agreare. Qëllim i këtij trupi është edhe tërheqja e investitorëve në fushën e agrarit, me atë që do t'i përgatisin të gjitha dokumentacionet e nevojshme, aplikacionet, marrjen e certifikatave dhe shërbimeve tjera këshilluese. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i shërbimeve % e të informuarit • Numri i shfrytëzuesve të shërbimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Anketa nga firmat dhe bujqit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Burimet e financimit për implementimin e qëllimit • Ndryshimi i pushtetit lokal.

☞ Të arrihet vetëqeverisje lokale efikase dhe efektive në shërbim të biznesit, përmes programeve për shkurtimin e burokracive administrative, p.sh funksionimi i sistemit njëspotel, etj. Ky qëllim afatshkurtër parasheh rreziqet dhe ndikimet negative të jashtme, si p.sh.

INDIKATORËT	BURIMET INFORMATIVE	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i shërbimeve • Numri i trajnimeve për shërbyesit e Zhel • Dhënia e lejeve në afatë më të shkurtë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna • Agjencioni për nëpunës civil • Anketa nga firmat dhe bujqit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Transferimi i përgjegjësive prej nivelit qendror në atë lokal.

Monitorimi dhe evaluimi i implementimit të këtyre qëllimeve strategjike:-

Në secilin vit të implementimit të planit strategjik, ekipet menaxheriale së bashku me ZhEL partneritetin, duhet të dorëzojnë raport për rezultatet e arritura në rrjedhim dhe programet e planifikuara për vitin e ardhshëm deri tek Këshilli i komunës dhe Prefekti.

Ky Raport duhet të dorëzohet dy herë në vit, në janar dhe shtator. Raporti i shtatorit duhet të përmbajë informata të mjaftueshme për aktivitete momentale, analiza dhe të dhëna për indikatorët e programeve dhe qëllimeve momentale, dhe në të njëjtën kohë raporti duhet të përmbajë edhe informata historike nga vitet e kaluara, ashtu që Këshilli dhe Prefekti i komunës të mund të japin drejtime dhe instruksione për planin për vitin e ardhshëm.

Gjatë vitit të njëjtë ekipi menaxherial e informon edhe ZhEL partneritetin çdo tre muaj, edhe atë për rezultatet e planifikuara që janë realizuar si dhe indikatorët për të gjithë projektet dhe programet gjatë vitit në rrjedhim. Ky plan ciklik dhe aktivitetet janë paraqitur në grafikonin e më poshtëm (Gantogram).¹⁴

Plani vjetor ciklik											
janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor
Implementimi i projekteve për këtë vit											
Raport deri tek Këshilli i								Raport deri tek Kryetari			
Përgatitja e projekteve dhe hartimi i planit për implementim									Miratimi i planit nga Këshilli		
											Miratimi i buxhetit për ZhEL
	Raporti deri te partneriteti për ZhEL										

Me këtë proces vjetor mundësohet ndjekje e vazhdueshme dhe kontrollë e planit strategjik gjatë periudhës dhjetë vjeçare, ndërsa në të njëjtën kohë edhe evaluimin e masave të planifikuara për ekonomi të qëndrueshme.

Vëllimi dhe numri i të dhënave të nevojshme për ndjekje dhe kontrollë gjatë përgatitjes së raporteve varret nga niveli i përgjegjësisë dhe rrjedha e definuar e informatave dhe masave kontrolluese.

¹⁴ Plani strategjik për zhvillim ekonomik lokal-komuna e Tearcës.

Procesi i kontrollit të punëve brenda komunës:-

Procesi i kontrollit është është proces i verifikimit dhe i rregullimit të aktiviteteve organizative me qëllim që performanca faktike të jetë në përputhje me standardet dhe objektivat e caktuara.

Sipas Fayol-it *“kontrolli konsiston në verifikimin nëse çdo gjë kryhet në përputhje me planin e punës së hartuar, me instruksionet e përgatitura dhe me parimet e vendosura. Ai ka si objekt zbulimin e dobësive dhe gabimet me qëllim t'i korigjojë dhe të parandalojë përsëritjen e tyre”*. Kontrolli Brenda sektorit *“ushrohet mbi gjithçka, mbi gjërat, njerëzit, veprimet”*.

L. Mullins theksonte se *“Një tipar i rëndësishëm i marrëdhënieve njerëz-organizatë, është nevoja për kontroll. Sistemet e kontrollit ekzistojnë në të gjitha sferat e operacioneve të organizatës dhe janë pjesë e domosdoshme e sistemit të menaxhimit. Kontrolli përqendrohet në matjen e suksesit, në arritjen e synimeve dhe objektivave të organizatës. Menaxheri duhet të kuptojë natyrën e kontrollit dhe se si të zbatojë sa më mirë sistemet e kontrollit me qëllim që të përmisojë performancën organizative”*.

Kontrolli është i lidhur ngushtë me të gjitha funksionet tjera udhëheqëse, ndërsa funksionet e organizimit dhe të lidhshmit, kontrolli mbështetet dhe i ndihmon për të siguruar që burimet të jenë të orientuar kundrejt arritjes së objektivave.

Në shumë aspekte, kontrolli konsiderohet si ana tjetër e medaljes (planifikimit). Sipas një autori, planifikimi dhe kontrolli mund të shihen figurativisht si dy pjesët përbërëse të një gërshëre e cila nuk mund të funksionojë pa ekzistencën e njëkohëshme të të dy elementeve të saj.

Kontrolli është një funksion i çdo udhëheqësi që nga Kryetari i komunës e deri tek udhëheqësi dhe nëpunësi më i ulët, por fusha dhe përgjegjësia e kontrollit të secilit është në varrësi të pozitës që ata zënë në piramidën institucionale.

Llojet e kontrollit:-Në varrësi të kohës së kryerjes, kontrolli mund të klasifikohet në tre kategori:

- Kontroll paraprak;
- Kontroll i ndërmjetëm;
- Kontroll përfundimtarë;

Procesi i kontrollit si një mekanizëm që përdoret nga udhëheqësi i sektorit dhe revizori ka për qëllim arritjen e objektivave për çdo organizatë konkrete, por për realizimin e tij ekziston një rrugë e përbashkët, e cila kalon nëpër disa faza (etapa):

- Faza e parë-Vendosja e standardeve;
- Faza e dytë-Matja e performances;
- Faza e tretë-Krahasimi i performancës me standardet;
- Faza e katërt-Vlerësimi dhe rregullimi i gjendjes.

Për fund mund të themi se funksionet e menaxherit siç janë: planifikimi, organizimi, udhëheqja, personeli (stafi) dhe kontrolli janë funksionet kryesore që e përbëjnë esencën e menaxhimit si proces në komunën e Tearcës. Pa këto funksione zhvillimi sektorial dhe vet komuna nuk do të kishte sukses, sepse ata ndihmojnë në efektivitetin dhe efikasitetin e punës në administratë.

